



Prishtinë, 18 dhjetor 2025
Kodi i ZRRE-së: V_2973 _2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Mbështetur në Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084); Nenin 30 par. 1 të Ligjit për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë (Nr. 08/L-258); Nenin 9 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së; Nenin 3, 4 dhe 8 të Rregullës Nr. 03/2023 për Vet-Konsumatorët me Burime të Ripërtërishme të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së, dhe Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej **504 kW**, e pranuar me datë 24.11.2025 nga aplikuesi personi juridik "ABRAZEN" SH.P.K., me adresë: fsh."Sine" Komuna e Istogut, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur më 18 dhjetor 2025 nxori këtë:

V E N D I M

PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. **APROVOHET** - kërkesa dhe miratohet Statusi i Prosumatorit jashtë Skemës Mbështetëse, për aplikuesin "ABRAZEN" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej **504 kW** në Komunën e Istogut.
- II. **OBLIGOHET** – aplikuesi "ABRAZEN" SH.P.K., me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DPE - 9023956 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtroj kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV. Aplikuesi "ABRAZEN" SH.P.K., sipas pikën I. të këtij Vendimi, pas marrjes së autorizimit për ndërtim është i detyruar që brenda afati prej tridhjetë (30) ditëve të dërgojë në ZRRE kontratën e nënshkruar me furnizuesin, ndër të tjera duke përfshirë edhe menaxhimin e tepricave, pa i zbuluar informatat konfidenciale, në pajtim me Nenin 8 të Rregullës Nr. 03/2023 për Vet-Konsumatorët me Burime të Ripërtërishme.

Arsyetim

- ZRRE, me datë 24.11.2025 nga aplikuesi "ABRAZEN" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej **504 kW** në Komunën e Istogut.



- Aplikuesi, s'bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergetik Nr. 14990 të datës 06.11.2025 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Pëlqimin Nr. 11-351-42446/246 të datës 21.11.2025 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis e Komunës së Istogut.
- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit "ABRAZEN" SH.P.K., dhe dëshmime të bashkangjitura, për marrjen e statusit të prosumatorit JASHTË SKEMËS MBËSHTETËSE dhe ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej **504 kW** në Komunën e Istogut, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.


V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, Anëtare


Gani Bucaj, Anëtar


Arta Isufi, Anëtare


Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Istogut,
- KEDS SH.A.,
- KESCO dhe
- Arkivit të ZRRE-së.